

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria Kosovës / Vlada Kosovo / Government of Kosovo
Ministria e Financave dhe Transfereve/ Ministarstvo za Finansije i Transfere
Ministry of Finance and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosovo / Tax Administration of Kosovo

ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Njësia Org.
Org. Jedin.
Org. unit: Z. P.

Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No: 02-06.4730

Nr. Faqeve
Broj stranica
No paper: 1

Data
Datum
Date: 22/12/22

01 HYRËSE PRISHTINË/A



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	22.12.2022 - GP-VI				
PËR/ZA/TO:	Azem Duraku – Udhëheqës – Divizioni i Prokurimit				
CC:	Ilir Murtezaj – Drejtor i Përgjithshëm i ATK Rifat Hyseni – Kryesues i Komitetit Drejtues të Projektit të Modernizimit Nahit Sharku – Anëtar i Komitetit Drejtues Nijazi Asllani – Anëtar i Komitetit Drejtues Hamit Mulaj – Anëtar i Komitetit Drejtues Ekrem Hysenaj – Anëtar i Komitetit Drejtues				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	1. Zana Bucaliu – Kryesuese e ekipit për menaxhimin e kontratës 2. Kushtrim Berisha – zëvendës kryesues 3. Fadil Revuçi – Anëtar 4. Arta Meha – Anëtare 5. Ilirjana Sheremeti – Anëtare				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandim për ndërprerje të kontratës me numër të prokurimit 1160017012214 për shkak të mos realizimit Kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik				
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	22.12.2022
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/for action					X
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/for approval					X
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/your attention					X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/for your information					X

Te nderuar,

Ekipi për Menaxhimin e Kontratës për Projektin e Modernizimit të TI-së: “Modernizimi i Sistemit të Teknologjisë Informative sipas kërkesave dhe nevojave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), me numër të brendshëm prokurimit 1160017012214, nr. eprokurimi: 11600174011214” të nënshkruar me datë 15.01.2020, I caktuar me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 09-06-704 I datës 10.02.2021, bazuar në përgjegjësitë sipas vendimit, Rregullores për Organizimin, Menaxhimin dhe Koordinimin e Projektit “Modernizimi i Teknologjisë së Informacionit në ATK” e datës 30.09.2020, Nenin 61.17 të Rregulla Dhe Udhëzues Operativ për Prokurimin Publik, dhe dispozitave tjera relevante, ju njofton dhe rekomandon:

12/12

Kontrata e lidhur në mes të Administratës Tatimore të Kosovës dhe Grupit ekonomik i operatorëve ekonomik: "IUNetworks" LLC; "PBC" sh.p.k.; "Mikrobiz" sh.p.k.; "Tax Accounting Group" sh.p.k.; with address: 38/1, Pushkin Str., Building 5, 0010, Yerevan, Republic of Armenia; Hamdi Mramori, no.1, Prishtinë; Rifat Berisha Str., E.10, no.33, Prishtinë; Chelsea Point, E4, no.21, Prishtinë, të përfaqësuar me autorizim nga lideri i grupit të operatorëve ekonomik "IUNetworks" LLC (ne vazhdim "Furnizuesi"), për furnizimin e Sistemit të Teknologjisë Informative sipas kërkesave dhe nevojave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), e cila përmban, përveç tjerash, Planin për Implementimin e Projektit me të cilin rregullohen afatet për dorëzimin, instalimin, furnizimin deri ne pranimin operacional te Sistemit të TI-së, në tërësi, është kontratë e cila deri më tani është amendamentuar dy here: Amendamenti i pare si rezultat i forcës madhore dhe Amendamenti i dytë si rezultat i vonesave në realizimin Planit të Implementimit të Projektit me shtyrje të afatit prej 6 muajsh nga Amendamenti nr.1.

Sipas klauzolës 19 të KPK (Klauzola 19 të KVK) Hartimi i Planit të Implementimin të Projektit është obligim i furnizuesit duke u bazuar në kapacitetet e tij ndërsa ATK ka kontribuar dhe është përpjekur në eliminimin e mos konformiteteve në plan (nëse ka pasur të tilla) dhe ka aprovuar në tërësi planin e prezantuar nga furnizuesi.

Sipas Amendamentit Nr. 1 të kontratës datë 17.04.2020, për shkak të efekteve të forcës madhore, respektivisht Klauzola 38 e KPK të Kontratës (pandemia Covid 19 dhe lufta në shtetin Armen) dhe referuar njoftimit të KRPP të datës 10.09.2020 nr. 32/2020, Autoriteti Kontraktues dhe Furnizuesi janë dakorduar për ndryshimin e afateve të liferimit dhe kalendarit të furnizimeve dhe instalimeve të licencave dhe sistemit ITAMIS.

Përkundër shtyrjes se afateve me Amendamentit Nr. 1 të kontratës datë 17.04.2020, fazat e testimit dhe funksionalizimit të fazës së parë të projektit, sipas kalendarit të instalimeve, nuk u përfunduan brenda afatit nga ana e OE, atëherë Autoriteti Kontraktues dhe Furnizuesi janë dakorduar që të shtyn përsëri afatet përmes Amendamentin Nr. 2 të Kontratës.

Sipas Amendamentit Nr. 2 të kontratës, i datës 22.07.2021, Autoriteti Kontraktues dhe Furnizuesi janë dakorduar për ndryshimin e Planit të instalimit dhe pagesave ndaj furnizuesit dhe Planin kohor të zbatimit për realizimin e kontratës.

Edhe pas Amendamentit Nr. 2 të Kontratës, furnizuesi nuk ka arritur që të respektoj afatet e përcaktuara në planin kohor të zbatimit për realizimin e kontratës, pavarësisht vërejtjeve dhe shqetësimeve që Autoriteti Kontraktues i ka drejtuar ndaj furnizuesit.

Në lidhje me aktivitetet e fazës së parë të projektit, Ekipi për Menaxhimin e Kontratës ka përcjellë tek Furnizuesi vërejtje për mos dorëzim të dokumenteve teknike për fazën e parë datë 11.08.2021, kërkesë për sqarimin e vonesave të shkaktuara dhe shprehje e shqetësimit ne lidhje me mos respektimin e planit kohor të zbatimit në lidhje me fazën e parë datë 01.09.2021 dhe 16.09.2021. Meqenëse shtrirja/funksionalizimi i fazës së parë të projektit është dashur të dorëzohet në ATK më datë 01.10.2021 dhe Furnizuesi nuk ka arritur ta përfundoj si aktivitet, atëherë Ekipi për Menaxhimin e Kontratës me datë 19.10.2021 ka rekomanduar Divizionin e Prokurimit që të vepohet sipas kushteve të kontratës në lidhje me vonesat në furnizimin e shërbimeve.

Me datë 20.10.2021 Furnizuesi është njoftuar për fillimin e aplikimit të dëmeve të likuiduara si rezultat i mos respektimit të planit kohor të zbatimit për realizimin e kontratës, respektivisht shtrirjen/funksionalizimin e fazës së parë.

Në lidhje me aktivitetet e fazës së dytë, Ekipi për Menaxhimin e Kontratës ka përcjellë tek Furnizuesi shqetësimin në lidhje me mos respektimin e planit kohor të zbatimit, vonesave të shkaktuara me datë 12.10.2021. Shqetësimet janë shprehur vazhdimisht edhe gjatë prezencës fizike të përfaqësuesit të

Furnizuesit në Kosovë nga 04.11.2021. Meqenëse shtrirja e pjesës së parë të Fazës së Dytë të projektit është dashur të dorëzohet në ATK me datë 02.12.2021 dhe Furnizuesi nuk ka arritur ta përfundojë si aktivitet, atëherë Ekipi për Menaxhimin e Kontratës me datë 14.12.2021 ka rekomanduar Divizionin e Prokurimit që të veproj sipas kushteve të kontratës në lidhje me vonesat në furnizimin e shërbimeve.

Me datë 14.12.2021 Furnizuesi është njoftuar për fillimin e aplikimit të dëmeve të likuiduara si rezultat i mos respektimit të planit kohor të zbatimit për realizimin e kontratës, respektivisht shtrirjen/funksionalizimin e pjesës së parë të fazës së dytë.

Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, Furnizuesi është njoftuar vazhdimisht nga Autoriteti Kontraktues dhe është kërkuar vazhdimisht respektimi dhe zbatimi i kontratës nga furnizuesi. Ekipi për Menaxhimin e Kontratës ka mbajtur dy here takim virtual me OE ku kemi rekomandua që nga OE ta pranojmë një raport me arsyetime se perse janë shkaktuar këto vonesa dhe po ashtu kemi rekomandua që krahas raportit ta bëjnë kërkesë për riorganizim të planit kohor të punës dhe afateve kohore të dorëzimit të moduleve në mënyrë që t'i shmangim vonesat e projektit dhe t'i definojmë më qartë veprimet e palëve si nga ana e OE po ashtu edhe nga ana e ATK-se. Gjatë takimeve është bërë e qartë për OE që kërkesa do të shqyrtohet bashkë me Grupet punuese, Komitetin Drejtues dhe Prokurimin e me pas do të veprohet sipas kushteve të kontratës, duke mos lëvizur datën përfundimtare të pranimi operacional të ITAMIS. Mirëpo, edhe pse jemi dakorduar për një gjë të tillë, në dy takimet me OE, OE është zotuar që do ta bëjë raportin se bashku me kërkesën për riorganizim të afateve, OE nuk ka bërë një hap të tillë.

Ekipi për Menaxhimin e Kontratës me datë 03.03.2022 nga Divizioni i Prokurimit ka pranuar njoftimin në lidhje me vlerën e llogaritur të dëmeve të likuiduara, të cilat deri më datën 02.03.2022 kanë arritur vlerën prej 980,189.53€. Vlera e llogaritur e dëmeve të likuiduara ka arritur në normën 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës.

Dëmet e likuiduara kanë filluar të aplikohen sipas nenit 12.6.1, 12.6.2, pika (a) të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) me të cilin rregullohen vonesat në përmbushjen e obligimeve kontraktuale në kohë nga furnizuesi, ku dëmet e likuiduara janë paraparë 0,25% në ditë të vlerës së produkteve, shërbimeve të pa dorëzuara në afat, e që kanë të bëjnë me lëshimin e fazës së parë të ITAMIS, që është dashur të dorëzohet deri me datën 01.10.2021, dhe produktet, shërbimet e pa dorëzuara që kanë të bëjnë me fazën e dytë - lëshimi - vendosja e pjesës së parë të ITAMIS për fazën e dytë që është dashur të dorëzohet deri me datën 02.12.2021, të cilat produkte, shërbime nuk janë dorëzuar sipas planit kohor të zbatimit për realizimin e kontratës në Amendamentin Nr.2 të kontratës të datës 22.07.2021.

Andaj, duke u bazuar në gjendjen e konstatuar përmes raporteve të Grupeve Punuese (me të cilat raporte konstatohet se OE nuk e ka përmbushur kontratën sipas Planit për Implementimin e Projektit, përkundër asaj se dy herë ju kanë zgjat afatet), Njoftimin e Divizionit të Prokurimit datë 03.03.2022 (me të cilin njoftim konstatohet se vlera e llogaritur e dëmeve të likuiduara ka arritur 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës), Ekipi për Menaxhimin e Kontratës (tutje EMK), mbi bazën e autorizimeve, referuar nenit 61.26 dhe 61.27 të "Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik", dhe dispozitave pasuese, rekomandon Divizionin e Prokurimit të veproj sipas kushteve të kontratës dhe dispozitave ligjore.

Pas rekomandimit të EMK, Divizioni i Prokurimit ka njoftuar OE me vërejtjen e fundit para ndërprerjes së kontratës për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve dhe obligimeve kontraktuale nga Furnizuesi, të dërguar Furnizuesit me datën 08.04.2022, ku në parashtrësë janë dhënë arsyetimet, argumentet, faktet, provat e paraqitura në parashtrësë.

Pas veprimit të ATK-së me shqiptimin e vërejtjes së fundit para ndërprerjes së kontratës, OE ka paraqitur afate për dorëzimin, testimin dhe pranimin operacional të moduleve për të cilat është zotuar në mënyrë të njëanshme se do t'i realizoj aktivitetet e tilla. EMK kemi përcjellë ecurinë e punës dhe afatet të cilat janë paraqitur vazhdimisht nga OE. Përveç përcjellës së afateve të paraqitura dhe ecurisë së punës, EMK nuk

Z. Rj

kemi pas se si te reagojmë dhe kemi qenë në pritje te afatit final sipas planit te punës nga Amendamenti nr.2 i cili aktualisht është në fuqi, respektivisht data 16.12.2022.

OE me datë 05.09.2022 ka dorëzuar në ATK kërkesën për zgjatjen e afatit të planit të implementimit të kontratës. Ekipi për Menaxhimin e Kontratës, duke pas parasysh rëndësinë e këtij projekti si projekt jetik për ATK-në, koston financiare të deritashme të projektit (referuar raportit të punes nga Ekipi praparak i Menaxhimit të Kontratës), rekomandimit të ekspertit të FMN-së dhe me qëllim të përfitimit sa më të madh nga kontrata, ka rekomanduar Divizionin e Prokurimit, që para së të shqyrtoj kërkesën e OE për zgjatjen e afatit të planit të implementimit të kontratës, të kërkohej nga OE që të paktën të bëj furnizimin dhe instalimin e 4 prej 21 moduleve në serverët e ATK-së sipas kërkesave teknike dhe funksionale, deri më datë 30.11.2022. Krahas kërkesës për implementimin e këtyre 4 moduleve, EMK nw pajtim me Menaxheren e Projektit ka rekomanduar OE që përzgjedhjen e moduleve për furnizim ta bëj OE duke u bazuar në modulet që kanë të aprovuara në parim Proceset Biznesore dhe/ose modulet të cilat, sipas vlerësimit të OE, janë më së afërti realizimit. Modulet e perzgjedhura nga OE per vendosje në serveret e ATK-së deri më datë 30.11.2022 jane:

1. Moduli i Regjistrimit të Tatimpaguesve,
2. Moduli i Menaxhimit të Perdoruesve,
3. Moduli i Fatures Elektronikee, dhe
4. Moduli i Menaxhimit të Parasë së gatshme.

Sa i perket modulit të Regjistrimit te Tatimpaguesve, modul i cili kerkon nderlidhje institucionale me palë të treta si ARBK, ARC etj., EMK dhe Menaxherja e Projektit kanë sugjeruar OE që ta rishikoj përzgjedhjen e këtij moduli per dorezim deri me datë 30.11.2022, por paravesisht kësaj OE ka vendosur dhe eshte zotuar për të njejtin.

EMK së bashku me Menaxheren e Projektit kanë komunikuar vazhdimisht me OE duke ia rikujtuar që Proceset Biznesore tashme të aprovuara te moduleve te përzgjedhura nuk mund te modifikohen, shtohen apo ndërrohen në këtë fazë (Modifikimet apo ndryshimet në modul, nëse nuk pengojnë funksionalizimin e modulit, mund të konsiderohen në periudhën e mirëmbajtës së kontratës) përveç rasteve kur moduli mund të konsiderohet i pa përfunduar apo rasteve te gabimeve teknike.

Gjithashtu OE me datë 08.12.2022 përmes email, është vënë në dijeni që pasi ta bëjë instalimin e këtyre moduleve, jo më larg se dt.30.11.2022 ta njoftoj EMK, sipas klauzolës 26.1 të KPK, që instalimi i 4 moduleve ka ndodhur, atëherë OE nuk e ka të drejtën për ndryshime/modifikime në modulet e vendosura në ambientet e ATK-se deri në përfundim të testimeve dhe raportit për konstatimin e instalimit nga Grupet Punuese.

Me datë 30.11.2022, ATK ka pranuar nga OE njoftimin me shkrim se ka furnizuar dhe instaluar 4 modulet së bashku me dokumentacionin përkatës sipas kërkesave teknike dhe funksionale të projektit. Sipas kontrstes, afati per trajtimin e furnizimeve të dorezuara eshte 14 ditë nga data e pranimi të njoftimit për instalimin e moduleve. Mirepo, meqenëse, OE nuk ka siguruar me kohë informatat për testim, respektivisht qasjet dhe përdoruesit me qëllim të testimit, testimit ka filluar me vonesë, pra me datë 12.12.2022 si shkak i vonesës së OE në ofrimin e informatave të nevojshme per testim.

Meqenëse, Grupet punuese gjatë testimit të moduleve kanë vërejtur ndryshime në versione të moduleve të vendosura në ambientet e ATK ku në momente të caktuara edhe testimi ka qenë i pamundur dhe se testimet është dashur të ndërpriten si rezultat i ndryshimeve të bëra nga OE në versionet e moduleve të vendosura në ambientet e ATK-së, Grupi Punues VII përmes Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë Informative, ka kërkuar ndërprerjen e qasjes për OE në ambientet e ATK-se deri në përfundim të testimeve të moduleve dhe përgatitjes së raportit final. EMK ka njoftuar OE në lidhje me vendimin për ndalimin e

ZB

qasjes në ambientet e ATK-së, dhe më pas ka bërë ndërprerjen e lidhjes VPN dhe Remote në të gjitha ambientet e brendshme të ATK-së (ambientet testuese të dedikuara për projekt).

Duke pas parasysh se sipas planit të implementimit të projektit, afati i fundit për integrimin e plotë të sistemit ITAMIS është 16.12.2022 dhe nga po kjo datë fillon së zbatuari periudha e garancionit të kontrtës, afati kohor sipas darkordimit për furnizimin dhe instalimin e 4 prej 21 moduleve ka qenë data 30.11.2022, që nënkupton se ATK ka pas në dispozicion 16 dite për vlerësim të moduleve, deri në arritjen e afatit të fundit për integrimin e plotë të sistemit ITAMIS.

Gjithashtu, me qellim të pasqyrimin të gjendjes faktike të secilit modul, EMK me datë 21.12.2022 përmes menaxheres së projektit ka pranuar raporte të detajuara nga grupet punuese në kuadër të projektit, të cilat përshkruajnë statusin e secilit modul deri më tani e të cilat janë:

Grupi I

1. Raport i rregullt për ecurinë dhe progresin e punës së Grupit Punues nr.1 - për ofrimin e shërbimeve për tatimpagues për Modulin e Regjistrimit të Tatimpaguesve, i datës 21.12.2022,

Grupi i III

1. Raport për ecurinë dhe progresin e punës së Grupit Punues, i datës 21.12.2022, dhe

Grupi VII

1. Raport i rregullt për ecurinë dhe progresin e punës së Grupit Punues, i datës 21.12.2022.

Edhe pas rekomandimit për dorëzimin dhe instalimin e moduleve sipas shkresës së datës 16.09.2022, duke u bazuar në raportet finale të grupeve punuese me të cilat vërtetohet se OE nuk ka arrit ta përmbushë as pjesërisht kontratën (dorëzimin dhe instalimin e 4 moduleve të gatshme për pranimin operacional deri me 30.11.2022) sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së, të përcaktuara në kontratë, dhe si rrjedhojë plani i implementimit të projektit ka arritur në afatin e fundit duke mbetur si plan i skaduar, pa produkt.

Andaj, meqenëse me datë 16.12.2022 ka përfunduar afati i fundit i planit të implementimit të kontratës, konkretisht Komisionimi –Testimi dhe Pranimi Operativ i ITAMIS, EMK, sikurse ka rekomanduar me shkresën e datës 21.03.2022, e konsideron kontratën e mbyllur dhe njëkohësisht prap rekomandon divizionin e prokurimit që të ndërmerr të gjitha veprimet ligjore, procedurale të parapara në kontratë dhe dispozita ligjore relevante, të cilat lidhen me ndërprerjen e kontratës.

Me respekt,

